

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6578  
E mërkurë, 6 prill 2022  
çmimi 0.40 €

Pas disa përplasjeve kohë  
më parë, Haradinaj dhe  
Rama takohen në Tiranë

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TË MARTËN ËSHTË SHËNUAR 23-VJETORI I MASAKRËS SË REZALLËS | FAQE 4

## MASAKRA E REZALLËS, DËSHMI E GJENOCIDIT TË SERBISË NË KOSOVË



Krerët shtetërorë të Kosovës kanë bërë homazhe të martën në memorialin e dëshmorëve në Rezallë. Në këtë fshat të komunës së Skenderajt më 5 prill të vitit 1999 forcat serbe kanë vrarë 98 persona. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë bërë thirrje që të dënohen përgjegjësit e masakrës së Rezallës. Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, në fjalimin e tij, ka thënë se masakra e Rezallës dhe të tjerat kudo që kanë ndodhur në Skenderaj e Kosovë, janë kujtimi ynë i dhembshëm, njëkohësisht lavdia e luftës heroike çlirimtare të Kosovës

### AKTUALE



**KAMBERI KËRKON PËRSËRITJEN  
E ZGJEDHJEVE NË LUGINË  
TË PRESHEVËS** F. 2

**LDK-ja KËRKON NGA PROKURORIA  
T'I HETOJË PUNËSIMET E FUNDIT  
NË KEK** F. 7

**ISH-KRYEDIPLOMATJA: KOSOVA  
MOS TA DËMTOJË MARRËDHËNIEN  
E RE ME IZRAELIN** F. 5



### EKONOMI

**BQK-JA: SEKTORI I SIGURIMEVE  
PO VAZHDON TË PËRBALLET  
ME PROBLEME** F. 3

**ÇFARË DO TË NDODHË ME  
FURNIZIMET E GAZIT NË EVROPË?** F. 8

### SPORT



**SOT PRITET RIZGJEDHJA E ADEMIT  
NË KRYE TË FFK-së** F. 10

**Zelensky thotë  
se 's'ka zgjidhje  
tjetër' pos të  
negociojë me  
Rusinë** | FAQE 2



## AGIM ALIU ZGJEDHET KRYETAR I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Kamberi kërkon përsëritjen e zgjedhjeve në Luginë të Preshevës

PRISHTINË, 5 PRILL - Politikani shqiptar në Luginë të Preshevës, Shaip Kamberi, kërko përsëritjen e zgjedhjeve parlamentare në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, komuna në jug të Serbisë, që njihen me termin Lugina e Preshevës.

Kamberi, i cili në zgjedhjet e 3 prillit garoi në kuadër të Koalicionit të Shqiptarëve të Luginës, tha se këto zgjedhje u karakterizuan me dalje të ulët të shqiptarëve, për shkak të, siç tha, pasivizimit të adresave të shqiptarëve.

“Shumë shqiptarëve u është pamundësuar e drejta elementare. E drejta për të votuar. Kjo e bën procesin zgjedhor jodemokratik. Zgjedhjet jo të lira”, shkroi Kamberi në “Facebook”. Prandaj ai tha se “zgjedhjet duhen të përsëriten në Luginën e Preshevës, duke zgjidhur paraprakisht çështjen e mohimit të së drejtës për të votuar për çdo qytetar të Luginës së Preshevës”. Këshilli Kombëtar Shqiptar,

institucion i vetëqeverisjes i komunitetit shqiptar në Serbi, ka thënë më herët se deri në fund të vitit të kaluar në këtë institucion ishin paraqitur rreth 6 000 qytetarë të komunave Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, të cilëve u ishin pasivizuar adresat.

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi më 2021 tha se Serbia, në mënyrë që të ulë sa më shumë që ta mundet numrin e shqiptarëve që jetojnë në jug të shtetit, po kryen një proces të quajtur “pasivizimi i banorëve shqiptarë” që jetojnë jashtë Serbisë, qoftë në Evropën Perëndimore apo në Kosovë. “Kjo masë, në thelb, është një formë e spastrimit etnik përmes mjeteve administrative”, thuhet në raportin e Komitetit të Helsinkit.

Sipas Komitetit të Helsinkit, kur adresa e banimit pasivizohet dhe hiqet nga libri amëz në Serbi, “ai person praktikisht pushon së ekzistuari”. “Ata nuk mund ta rinovojnë letërnjoftimin ose pasaportën e

skaduar, ta regjistrojnë makinën, të kenë qasje në kujdesin shëndetësor ose shërbime sociale, të blejnë ose shesin pronë, ose të votojnë në zgjedhjet lokale ose të përgjithshme”, thuhet në raportin e këtij institucioni.

Beogradi zyrtar, në përgjithësi, nuk e ka komentuar çështjen e pasivizimit të adresave. Por, në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” në muajin shkurt 2021, ministrja e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë e Serbisë, Marija Obradović, ka folur për pasivizimin e së drejtës së votës, duke thënë se kjo ndodh kur nga inspektimet në terren të zyrtarëve të Ministrisë së Brendshme të Serbisë, konstatohet se vendbanimi i personave nuk është në adresën që e kanë paraqitur.

Kamberi tha se Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës, që përbëhet nga Partia për Veprim Demokratik, bashkë me Partinë Demokratike dhe Lëvizjen e



Progresit Demokratik, mori 9 644 vota. Ai tha se këto vota ende nuk garantojnë se shqiptarët kanë fituar një mandat në parlamentin e ri serb. Partitë shqiptare në Serbi në këto zgjedhje garuan me dy lista: Koalicioni i Shqiptarëve të Bashkuar dhe Alternativa Demokratike Shqiptare - me gjithsej 20 kandidatë. Këto dy lista kanë marrë afër 13 000 vota. Në bazë të një vlerësimi të Organizatës për Siguri dhe

Bashkëpunim në Evropë (OSBE), të bërë në vitin 2015, u tha se janë rreth 70 mijë banorë shqiptarë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Rreth 20 000 shqiptarë raportohet se kanë migruar në Kosovë për arsye të ndryshme. Në zgjedhjet presidenciale, sipas rezultateve paraprake, ka fituar presidenti aktual Aleksandar Vučić, ndërkaq në ato parlamentare ka fituar partia e Vučićit, Partia Përparimtare Serbe.

## Zelensky thotë se “s’ka zgjidhje tjetër” pos të negociojë me Rusinë

KIEV, 5 PRILL - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, tha se “nuk ka zgjidhje tjetër” pos të negociojë për fundin e luftës me Rusinë, edhe pse ai tha se negociatat janë të vështira për shkak të shenjave që sugjerojnë se forcat ruse mund të kenë kryer mizori ndaj civilëve, që nxitën dënim nga komuniteti ndërkombëtar dhe shtuan thirrjet për hetime të krimeve të luftës.

Duke folur në një intervistë me gazetaret ukrainas, që u transmetua më 5 prill në transmetuesin shtetëror, Zelensky i quajti ngjarjet në qytetin Buça “të paharrueshme” dhe tha se “të gjithë ne, përfshirë edhe veten, do ta perceptojmë edhe mundësinë e negociatave si



një sfidë”.

“Së pari, sfida është e brendshme, është sfidë njerëzore. Më pas, kur e merr veten dhe duhet ta

bësh, mendoj se ne nuk kemi zgjidhje tjetër”, shtoi ai. Presidenti ukrainas pritet që më 5 prill t’u drejtohet Kombeve të

Bashkuar përmes videolidhjes. Intervista e Zelenskyt vjen vetëm një ditë pasi ai vizitoi Buçan, që gjendet në periferi të Kievit, ku zyrtarët ukrainas thanë se janë gjetur trupa të civilëve të vrarë. Trupa u gjetën në rrugë dhe shtëpi të këtij qyteti.

Pamjet nga Buça kanë nxitur dënim ndërkombëtar ndaj Rusisë, e cila ka mohuar se është përgjegjëse për vrasjet.

Kryetari i Buças, Anatoliy Fedoruk, tha se vrasjet - ku vlerësohet se janë vrarë afër 300 civilë, ishin bërë “për t’u hakmarrë rezistencës ukrainase”.

Zelensky tha se Ukraina ka ofruar në bisedimet e paqes që të ketë një status neutral, që do të kishte garanci të sigurisë nga

shtetet e tjera.

Në intervistën e 5 prillit ai theksoi e Ukraina ende nuk ka një listë të shteteve që janë të gatshme që të ofrojnë garanci të sigurisë. “Shtete të ndryshme veçse kanë garantuar për gjëra të ndryshme. Deri më tani ne nuk kemi pranuar një listë të shteteve që janë të gatshme të na bashkohen 100 për qind. Ne na duhet një rreth i shteteve që janë të gatshme të na ofrojnë armët e duhura brenda 24-orësh. Ne na duhet që sanksionet të përpilohen paraprakisht dhe në momentin që ne ndihemi të kërcënuar nga Federata Ruse, ato shtete të bashkohen dhe t’i prezantojnë masat e duhura menjëherë”, tha ai.

## Pas disa përplasjeve kohë më parë, Haradinaj dhe Rama takohen në Tiranë

TIRANË, 5 PRILL (ER) - Dy politikanët më të ashpër kundër njëri-tjetrit, Ramush Haradinaj dhe Edi Rama, janë takuar të martën në Tiranë. Edi Rama gjatë vitit 2018 kishte përdorur një shprehje të rëndë ndaj kundërshtarëve të Hashim Thaçit (në këtë rast për Haradinajn) për çështjen kombëtare, duke i cilësuar si “gomarë”.

Nga analistët kjo ishte konsideruar si ofendim për

Ramush Haradinajn, që kishte qenë kryeministër në atë kohë. Po ashtu, Rama dhe Haradinaj ishin përplasur edhe për taksën 100 për qind që kishte vendosur Kosova për Serbinë.

Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në ekonomi, infrastrukturë, siguri e politikë të jashtme, ishin temat kryesore të takimit në mes të Ramës dhe Haradinajt, ka bërë me dije lideri i AAK-së. “Bashkëbiseduam, gjithashtu,

për projektin e hekurudhës Prishtinë - Durrës si projekt i domosdoshëm për të dyja vendet, si dhe dhënien e dyshtetësisë për qytetarët tanë. Falënderova kryeministrin Rama për ndihmën e shtetit shqiptar gjatë krizës energjetike në Kosovë dhe shpreha nevojën e gjetjes së mënyrave të bashkëpunimit të ngushtë mes dy vendeve në këtë kohë aspak normale”, ka thënë Haradinaj.



# Agim Aliu zgjedhet kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 5 PRILL-** Në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Kosovës, që është mbajtur të martën, e që është udhëhequr nga kryetari i deritashëm i AKK-së, Imri Ahmeti, është zgjedhur bordi dhe kryetari i ri për mandatin e ardhshëm katërvjeçar.

Në këtë takim me shumicë votash dhe në bazë të formulës, sipas statutit të AKK-së bazuar në zgjedhjet lokale të vitit 2021, kryetari i ri i Asociacionit të Komunave të Kosovës është zgjedhur Agim Aliu, kryetari i komunës së Ferizajt, ndërsa nënkryetar është zgjedhur Imri Ahmeti, kryetari i komunës së Lipjanit. "Nder e privilegj të veçantë të zgjidhem sot kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Komunat janë porta e parë e çdo halli të qytetarëve gjersa kryetarët e komunave, hallka lidhëse e adresimit të nevojave të qytetarëve në institucionet qendrore. Andaj, duke e falënderuar për punën e

kontributin, strukturën e deritashme të AKK-së, u zotova se bashkë me kolegët e tjerë kryetarë të komunave, do të jemi zë i fuqishëm e i palodhur për artikulimin e kërkesave qytetare. Faleminderit për besimin dhe mbështetjen e fuqishme kryetarë të komunave të Kosovës dhe delegatëve të Kuvendit Zgjedhor të Asociacionit të Komunave të Kosovës!", ka thënë Aliu.

Ndërsa anëtarë të bordit janë zgjedhur: Shaqir Totaj, kryetar i komunës së Prizrenit, Bali Muharremaj, kryetar i komunës së Suharekës, Xhafer Gashi, kryetar i komunës së Obiliqit, Sokol Haliti, kryetar i komunës së Vitisë dhe Dragan Petković, kryetar i komunës së Parteshit.

Po ashtu, Kuvendi i Përgjithshëm i Asociacionit të Komunave të Kosovës me shumicë votash ka aprovuar raportet vjetore të vitit 2021 dhe planet për vitin 2022.

Në këtë takim të Kuvendit janë diskutuar edhe tema të lobimit me interes të qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.



## BQK-ja: Sektori i sigurimeve po vazhdon të përballet me probleme

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 5 PRILL-** Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se sektori i sigurimeve në Kosovë, që nga fillimi i aktivitetit të tij, është ballafaquar me probleme, performancë jo të kënaqshme, si dhe mospajtueshmëri me kërkesat rregullatore të parapara me legjislacionin në fuqi të disa sigurues. Sipas BQK-së, kjo gjendje e tillë është ndikuar edhe nga disa faktorë: aplikimi i tatimit në bruto primin e shkruar apo tatimin në qarkullim prej 5-përqindësh, detyrimin e sektorit të sigurimeve për kontribut ndaj Kryqit të Kuq me 1 për qind të brutoprimeve, si dhe dëmet e shkaktuara nga automjetet e pasiguruara që qarkullojnë në territorin e Republikës së Kosovës. "Derisa çështja e tatimit në qarkullim dhe kontributit për Kryqin e Kuq janë adresuar, automjetet e pasiguruara vazhdojnë të mbesin shqetësim për sektorin e sigurimeve. Duke



marrë parasysh ngecjen e këtij sektori, gjatë viteve të fundit BQK-ja ka ndërmarrë një varg masash dhe reformash me qëllim që

sektori i sigurimeve të sigurojë pajtueshmëri me kornizën ligjore në fuqi. Për këtë qëllim gjatë viteve të fundit BQK-ja ka

marrë me dhjetëra masa administrative kundrejt siguruesve, përfshirë edhe revokimin e dy licencave. Si

rezultat i këtyre masave të ndërmara gjatë tre vjetëve të fundit aksionarët e disa prej siguruesve kanë injektuar kapital në vlerë mbi 16 milionë euro", është thënë në njoftimin e BQK-së. Më tej, në njoftim, është thënë se si rrjedhojë, më 31 mars 2022, të gjithë siguruesit që ushtrjnë aktivitetin e sigurimeve në vend janë në përputhje me kërkesat ligjore të BQK-së. "Duke marrë parasysh faktin që sektori i sigurimeve në Kosovë është tërësisht i kapitalizuar dhe në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi, BQK-ja, në bashkëpunim me Bankën Botërore, janë duke ndërmarrë veprimet përfundimtare për ta liberalizuar tregun e produktit të autopërgjegjesisë. Që nga data 4 prill 2022 në BQK janë duke qëndruar ekspertët e Bankës Botërore me të cilët do të dizajnohet modeli i ri i primit të bazuar në rrezik dhe udhërrëfytyrës për solvencën 2", është thënë në njoftimin e BQK-së.

## Tahiri kërkon që ministri Sveçla të raportojë në Komisionin për Administratë

**PRISHTINË, 5 PRILL (ER)** - Në mbledhjen e Komisionit për Administratë Publike, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka kërkuar që urgjentisht të vijë për raportim ministri Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. "Ishte vetë ministri që pati deklaruar se

Ligji i Pagave do të vijë në Kuvend në fund të marsit. Tani kur qeveria e ka kthyer këtë ligj në pikën zero, nuk ka komunikim as kumtesë nga qeveria rreth kësaj çështjeje me rëndësi jetike për zyrtarët publikë", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se, fatkeqësisht,

agjenda legislative e qeverisë nuk është asgjë më shumë sesa një listë dëshirash për t'i vendosur disa tema, por pa efekte. "Qeveria ka parkuar agjendën legislative, nuk merret me ligje vitale dhe nuk po merret me të!", ka thënë Tahiri.





TË MARTËN ËSHTË SHËNUAR 23-VJETORI I MASAKRËS SË REZALLËS

# Masakra e Rezallës, dëshmi e gjenocidit të Serbisë në Kosovë

Krerët shtetërorë të Kosovës kanë bërë homazhe të martën në memorialin e dëshmorëve në Rezallë. Në këtë fshat të komunës së Skenderajt më 5 prill të vitit 1999 forcat serbe kanë vrarë 98 persona. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës kanë bërë thirrje që të dënohen përgjegjësit e masakrës së Rezallës. Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, në fjalimin e tij, ka thënë se masakra e Rezallës dhe të tjerat kudo që kanë ndodhur në Skenderaj e Kosovë, janë kujtimi ynë i dhembshëm, njëkohësisht lavdia e luftës heroike çlirimtare të Kosovës

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

Skenderaj, 5 prill - Me një manifestim të organizuar nga komuna e Skenderajt, të martën është shënuar 23-vjetori i masakrës së Rezallës, në të cilën, më 5 prill të vitit 1999, qenë vrarë dhe masakruar 98 qytetarë të kësaj komune.

Delegacioni i komunës, i udhëhequr nga kryetari Fadil Nura, nënkryetari Sami Lushtaku, Vlora Çitaku, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bashkëluftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjarë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, dhe zyrtarë e përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, kanë bërë homazhe te lapidari në nderim të dëshmorëve dhe martirëve të Rezallës, Marinës dhe fshatrave të tjera.

Homazheve u është bashkuar edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. Kryetari i komunës, Fadil Nura, në fjalimin e tij, ka thënë se masakra e Rezallës dhe të tjerat kudo që kanë ndodhur në Skenderaj e Kosovë, janë kujtimi ynë i dhembshëm, njëkohësisht lavdia e luftës heroike çlirimtare të Kosovës. "98 bashkëqytetarë tanë, pleq, burra e djem të rinj, u vranë dhe u masakruan më 5 prill të vitit 1999. Sot, në 23-vjetorin e ngjarjes, i kujtojmë me krenari dhe mall të gjithë të vrarët. Pajtim nuk mund të ketë derisa kriminelët të japin llogari për krimet e tyre në Rezallë. Kriminelët kanë emër e mbiemër. Përgjegjësia duhet të bie mbi secilin që ka dhënë urdhër. Edhe mbi Lubisha Dikoviqin, mbi eprorët dhe vartësit e tij, të cilët kanë kryer këtë masakër çnjerëzore. Lavdi të gjithë të rënëve në masakrën e

Rezallës!", ka thënë kryetari Nura. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se pa gjakun e derdhur të dëshmorëve dhe martirëve, si dhe sakrificën e popullit, Kosova nuk do të kishte lirinë dhe shtetësinë. "Jemi këtu për të bërë homazhe për 98 martirët të cilët u masakruan prej forcave pushtuese të ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë 23 vjet më parë. Ajo që e bën edhe më të rëndë këtë masakër, ashtu sikur edhe shumë masakra të tjera të Serbisë, është fakti që plagët janë ende të hapura. Para gjashtë muajve ne riarrosëm këtu edhe të tjerë trupa të gjetur të këtyre martirëve, por Serbia nuk po i dorëzon qindra trupa të tjerë të cilët janë të zhdukur me dhunë dhe mbahen të fshehur pikërisht në ato vende nëpër të cilat kanë ngritur edhe poligone ushtarake", ka theksuar Konjufca, duke shtuar se nuk ka kurrfarë dyshimi që përgjegjëse për këtë

gjenocid mbi popullin e pafajshëm të Kosovës është Serbia. "Ne nuk do të ndalemi deri kur Serbia të japë përgjegjësi për gjenocidin e kryer dhe të dënohen të gjithë kriminelët për masakrën e Rezallës dhe të gjitha masakrat e tjera që kanë ndodhur në Kosovë. Lavdi martirëve të cilët dhanë jetën për lirinë e Kosovës, sepse pa gjakun e tyre dhe pa sakrificën e popullit të Kosovës nuk do të mund të vinte liria të cilën e gëzojmë sot, e as shteti i Kosovës", ka deklaruar Konjufca.

Në emër të familjeve të dëshmorëve të Kosovës ka folur Xhavit Jashari, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, ndërsa historikun e masakrës së Rezallës e ka paraqitur mësimdhënësi i historisë, Arben Zabeli.

Në përvjetorin e kësaj masakre kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj, kanë bërë homazhe në Rezallë. "Vendosëm lule të freskëta këtu te lapidari dhe varrezat e këtyre martirëve të kombit, të cilët u pushkatuan mizorisht vetëm për shkak se ishin shqiptarë dhe

dëshironin të jetojnë të lirë në trojet e tyre stërgjyshore. 98 burra dhe djem u grumbulluan dhe u ekzekutuan nga forcat serbe dhe vetëm 3 që kanë shpëtuar, kjo ka ndodhur rastësisht. Qëllimi ka qenë që të mos e lënë asnjë të gjallë, andaj kjo masakër është dëshmi e gjenocidit të Serbisë në Kosovë", ka thënë Kurti.

Duke folur për rivarrimin në muajin tetor 2021, të eshtrave të nëntë viktimave të Rezallës, kryeministri Kurti ka theksuar se me ekzekutim mizor e barbar forcat serbe ua vodhën jetën e pastaj ua vodhën edhe kufomat. "Më 30 shtator të vitit 2021 u kthyen në Kosovë eshtrat e zvarrosura në Kizhevack, Serbi që, sipas raporteve të identifikimit, iu përkisnin shtatë identifikimeve të reja nga masakra e Rezallës, si dhe dy ribashkimeve me eshtrat e zvarrosura vite më parë nga varreza masive në Rudnicë të Rashkës, në Serbi. Nuk ka dyshim që gjenocidi i Serbisë njihet edhe botërisht, përveçse nga ne shqiptarët që e përjetuam, andaj edhe drejtësia vendore dhe ajo ndërkombëtare duhet pa vonesë dhe me ngulm të veprojnë në mënyrë që përgjegjësit, urdhërdhënësit dhe ekzekutorët të gjykojnë e të dënohen", ka

# Ish-kryediplomatja: Kosova mos ta dëmtojë marrëdhënien e re me Izraelin

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 PRILL - Ish-ministrja e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se raportimi pas gati një muaji se ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, qenka takuar me ministrin e Jashtëm të autoriteteve palestineze Al-Maliki gjatë forumit të Antalya, flet shumë për mungesën e konfidencës politike dhe pazotësisë diplomatike për të qëndruar fort me dy këmbë në tokë prapa qëndrimeve e interesave tona si shtet e si popull. “Mostransparenca e ministres rreth takimit të saj me ministrin palestinez e dëmton Kosovën, dëmton marrëdhënien e re me Izraelin ende pa u konsoliduar mirë, dëmton interesat afatgjatë të Kosovës për të siguruar njohje të reja nga shtetet e Lindjes së Mesme dhe ndihmon pozicionin e Serbisë për ta forcuar ‘koalicionin ndërkombëtar’ kundër subjektivitetit të shtetit tonë”, ka thënë Haradinaj-Stublla. Ajo ka theksuar se Kosova, përveç që ka punuar shumë për të ndërtuar marrëdhënie zyrtare diplomatike me shtetin e Izraelit, ka bërë përpjekje të mëdha për ta

zmbursur kampanjën ilegale të Serbisë për t’i penguar e dëmtuar njohjet ekzistuese dhe ato potenciale të Republikës së Kosovës. “Këtu me vite të tëra tashmë dihet se është ndihmuar shumë nga autoritetet palestineze, duke shfrytëzuar lidhjen e tyre të ngushtë historike me disa shtete të Lindjes së Mesme. Mos të harrojmë se kjo kampanjë kishte ndodhur ende pa vendosur Kosova marrëdhënie diplomatike me Izraelin dhe ende pa vendosur për hapjen e ambasadës në Jerusalem. Prandaj Kosova nuk ka asnjë përgjegjësi morale ndaj Palestinës, dhe ministrja nuk është dashur të ndihet në borxh duke e mbajtur larg publikut”, është shprehur ish-ministrja Haradinaj-Stublla. Sipas saj, Gërvalla është dashur t’i rendisë qartë në takim dhe, po ashtu, menjëherë në njoftimin publik, të gjitha argumentet e Kosovës, sepse jemi në të drejtën tonë që na takon si shtet sovran. “Për më shumë, vendimi i Kosovës për hapjen e ambasadës në Jerusalem në mars 2021 në asnjë mënyrë nuk ishte vendim për apo kundër Izraelit apo Palestinës. Kosova, thjesht, ka përcjellë praktikën diplomatike të vendosjes së ambasadës aty ku shteti pritës e konsideron kryeqytet dhe seli



administrative të qeverisë. Meqë sensitiviteti i kësaj teme ishte i lartë, jemi kujdesur që objekti i ambasadës sonë të jetë në pjesën perëndimore shumë afër ambasadës amerikane, dhe jo në pjesën lindore të qytetit që, sipas Marrëveshjes së Oslos të vitit 1993, i takon Palestinës. Heshnja e ministres sonë hodhi poshtë gjithë

këtë mund, duke ia dhuruar terrenin diplomatik vetëm Palestinës dhe Serbisë për t’i amplifikuar mesazhet e interesit të tyre që bien ndesh me interesat shtetërore të Kosovës dhe duke vendosur Kosovën automatikisht në pozicion defanziv dhe të dëmshëm”, ka deklaruar ajo. Haradinaj-Stublla ka theksuar se

MPJD urgjentisht duhet të japë sqarime, me një deklaratë publike në shqip dhe anglisht rreth takimit, temave dhe pozicionit të Kosovës rreth asaj që ka deklaruar MPJ e autoriteteve palestineze pas takimit me Kosovën, për ta riparuar dëmin tashmë të shkaktuar me shtetin mik të Izraelit.



theksuar Kurti. Ndërkaq presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, përmes një deklarate për medie ka përkujtuar masakrën e Rezallës në 23-vjetorin e saj. “Duke u përpjekur t’i fshehin gjurmët e krimit, autorët zhdukën 44 viktima, një pjesë e të cilëve u gjetën vite më pas në një varrezë masive në Rudnicë të Serbisë. E vërteta nuk mund të fshihet, ndaj do të jetë përkushtim ynë i vazhdueshëm. Për Rezallën dhe çdo vend të Kosovës ku janë kryer krime nevojitet drejtësi. Të rënë në këtë masakër nuk do të harrohen kurrë dhe bashkë me përvjetorët e lirisë do të kujtohen çdoherë!”, ka theksuar

presidentja Osmani. Masakrën e Rezallës e ka përkujtuar edhe ish-kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, i cili ka thënë se kjo masakër është dëshmi e fortë për faktorin ndërkombëtar “që t’i bëjë presion Serbisë për krimet që ka bërë në Kosovë”. “Masakra e Rezallës, bashkë me masakrat e tjera që agresori serb bëri mbi civilët shqiptarë, i dhanë drejtimit të ri luftës sonë çlirimtare, duke bindur shtetet e botës demokratike që Serbia po kryente gjenocid në Kosovë dhe se lufta e UÇK-së ishte luftë në mbrojtje të popullit dhe vendit tonë. Ajo është shembull i sakrificës dhe dëshmi se pa

sakrificë e gjak nuk ka liri. Ajo, po ashtu, është dëshmi e krimeve dhe gjenocidit që kriminelët serbë bënë në Kosovë, duke mos kursyer askënd që fliste shqip e që mbronte pragun e shtëpisë. Respektin e nderimin ndaj të rënëve e dëshmojmë me angazhim maksimal për shtetin tonë, për mirëqenien e qytetarëve e gjeneratave që vijnë”, ka thënë Jashari. Më 5 prill të vitit 1999 në masakrën e kryer në Rezallë janë vrarë 98 persona. Kryerësit e kësaj masakre nuk kanë dalë ende para drejtësisë. Më 2016 familjet e viktimave të masakrës së Rezallës kanë ngritur kallëzim penal kundër

ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë serbe, Lubisha Dikoviç. Dikoviç gjatë luftës në Kosovë ka qenë komandant i Brigadës 37 të ushtrisë jugosllave. Kallëzimin në Prokurorinë Speciale të Kosovës familjarët e patën ngritur edhe kundër Dejan Rangelloviçit, i cili në atëbotë ka komanduar Batalionin e Dytë të brigadës së njëjtë. Ditët e fundit udhëheqësit shtetërorë të Kosovës kanë kryer homazhe edhe në fshatrat e tjera për t’i përkujtuar viktimat e luftës. Në mesin e tyre ka qenë vizita në Krushën e Madhe, në të cilën janë vrarë 241 persona. Ata kanë vizituar edhe të mbijetuarit

e familjes Berisha në Suharekë, së cilës i janë vrarë 50 anëtarë më 26 mars të vitit 1999. Homazhe janë bërë edhe në Lybeniq të Pejës. Kosova ka dalë nga lufta e vitit 1998-’99 me mbi 13 000 persona të vrarë, mbi 800 000 të zhvendosur dhe mbi 5 000 të zhdukur. Qindra shqiptarë të vrarë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi, të cilët janë bartur nga forcat serbe për t’i fshehur krimet. Deri më tani nga Serbia në Kosovë janë kthyer mbetje mortore të rreth 1 000 personave. Edhe 23 vjet pas luftës të zhdukur vazhdojnë të jenë mbi 1 600 njerëz.

## Fillon renovimi i objektit të gjimnazit "Hamëz Jashari"

SKENDERAJ, 5 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, së bashku me drejtorin për Arsim, Kastriot Duraku, kanë vizituar punimet për meremetimin e objektit të gjimnazit "Hamëz Jashari" në kuadër të programit të

bashkëfinancimit me Fondin Kosovar të Efiçencës. Në kuadër të këtij programi projekti parashihet ndërrimin e tërësishëm të kulmit, dritareve, fasadimin efiçient, riuinstalimin e nxemjes qendrore dhe nivelizim.

Kryetari Nura, në një postim në llogarinë e vet në "Facebook", duke iu përgjigjur zërave se do të rrethohej objekti i gjimnazit, ka thënë se "nuk është rrethim, larg qoftë, por ringritje dhe ruajtje e historisë sonë së lavdishme".



## Nis aksioni i madh i pastrimit të ambientit në Malishevë

MALISHEVË, 5 PRILL (ER) - Në komunën e Malishevës ka nisur të martën një aksion i madh i pastrimit të qytetit për të vazhduar në ditët në vazhdim edhe nëpër fshatra.

I pari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, i shoqëruar nga nënkryetari Vesel Krasniqi, kryesuesi i Kuvendit, Argjend Thaçi, drejtorët, punëtorët e administratës komunale, institucionet

shëndetësore, Policia e Kosovës, kompanitë publike; Ekoregjioni, Hidroregjioni, Zjarrfikësit, OJQ-të, si dhe shumë qytetarë vullnetarë, iu bashkuan këtij aksioni të pastrimit, për një ambient të

pastër, dhe që njëkohësisht edhe i paraprinë shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Tokës, që është më 22 prill. "Ne si komunë, në bashkëpunim me institucionet e tjera të përfshira dhe gjithë

qytetarët, do të angazhohemi maksimalisht për një ambient më të pastër në tërë komunën tonë. Ky është veç fillimi i realizimit të projektit për 'Malishevën urbane', ka thënë kryetari Kastrati.



## Shpërndahen 400 pako ushqimore për disa familje në Gjilan

GJILAN, 5 PRILL (ER) - Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me organizatën "Qatar Charity", kanë shpërndarë të martën 400 pako ushqimore bazike për familjet që kanë nevojë. Në këtë organizim të shpërndarjes së tyre mori pjesë kryetari Alban Hyseni, nënkryetarja Leonora Morina Bunjaku dhe drejtorët

komunalë, Aurorë Osmani Buca e Kushtrim Zeqiri. "Ky aktivitet bëhet në mbështetje të familjeve në kohë pandemie, sidomos tash që jemi në muajin e Ramazanit, dhe është shumë i mirëpritur, prandaj e falënderoj organizatën 'Qatar Charity' për mbështetjen e madhe për këto familje. Ky është vetëm një prej

aktiviteteve që e kemi nisur me këtë organizatë", ka thënë me këtë rast kryetari Hyseni. Përfaqësuesi i organizatës Qatar Charity, Ukë Rexhepi, pasi e falënderoi kryetarin Hyseni për bashkëpunimin, tha se kjo është një dhuratë për familjet që kanë nevojë në Gjilan për t'ua zbutur sadopak gjendjen ekonomike.



## Drejtoria e Inspeksionit në Mitrovicë liron hapësirat publike

MITROVICË, 5 PRILL (ER) - Në vazhdim të inspeksioneve të përditshme për lirim të hapësirave publike të uzurpuara, me kërkesë të qytetarëve të Mitrovicës, inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë ndërmarrë

aksion në rrugën "Bajram Curri", duke bërë lirim të tyre. Me këtë rast, inspektorët komunalë kanë ndërprerë punimet në mungesë të lejes nga organi kompetent, duke konstatuar se janë dëmtuar trotuarët të cilat shërbejnë për

qarkullim të lirë të qytetarëve. Drejtori i Inspeksionit, Valon Brahimi, ka bërë me dije se aksione të kësaj lloji do të vazhdojnë deri në eliminimin e tërësishëm të kësaj dukurie, në mënyrë që të lirohen hapësirat e uzurpuara komunale.



## Zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe ata të Maqedonisë fillojnë trajnimet e përbashkëta

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Ka filluar sesioni trajnues pesëditor për 20 zyrtarë të Policisë së Kosovës të cilët së bashku me kolegët nga Maqedonia e Veriut janë duke u trajnuar në fushën e mbledhjes së informacioneve, analizimit, shkëmbimit të tyre, si dhe në aspektin e kategorizimit të armëve, eksplozivëve artizanalë dhe ndërlidhjes me konceptin e Policimit të drejtuar nga Inteligenca dhe Policimi në

Bashkësi. Policia e Kosovës ka njoftuar se qëllimi i këtij trajnimi është fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të zyrtarëve nga të dyja vendet për të kontrolluar në mënyrë efikase armët e vogla dhe të lehta, identifikimin dhe njohjen e kategorizimit të armëve si dhe njohjen me kornizën vendore dhe ndërkombëtare që rregullon fushën e armëve të vogla dhe të

lehta, municionin dhe eksplozivët. Ky aktivitet është mundësuar në kuadër të projektit të përbashkët në mes të UNDP-së në Kosovë dhe UNDP-së në Maqedoninë e Veriut përmes mbështetjes financiare nga Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, Franca, Holanda dhe Norvegjia me mbështetje nga Bashkimi Evropian.



## Kosova dhe Zvicra nënshkruajnë marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Të martën në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u nënshkrua marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, gjegjësisht nga ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, dhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly. Kjo marrëveshje ka për qëllim forcimin dhe thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike në çështjet penale në mes të dy vendeve, lehtësimin dhe harmonizimin e procedurave ligjore për një bashkëpunim sa më të frytshëm dhe efikas. Marrëveshja në fjalë është hartuar në frymë dhe në

përputhje me rregullat dhe parimet e përcaktuara nga Konventat e Këshillit të Evropës të fushës. Marrëveshja do ta rregullojë procedurën rreth ofrimit të ndihmës juridike të ndërsjellë në çështjet penale, duke ngërthyer standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe duke reflektuar praktikatat më të mira evropiane përkitazi me kërkesat e kohës. Kjo marrëveshje parasheh marrjen e dëshmive, komunikimin e drejtpërdrejtë në mes të organeve tona gjyqësore, themelimin e grupeve të përbashkëta hetimore, si dhe ngrirjen, sekuestririmin dhe konfiskimin e të ardhurave dhe instrumenteve të kimit.



## LDK-ja kërkon nga prokuroria t'i hetojë punësimet e fundit në KEK

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 PRILL - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e ka kritikuar Lëvizjen Vetëvendosje për emërim të militantëve në borde të ndërmarrjeve publike. Zëdhënësja e kësaj partie, Sibel Halimi, ka thënë se punësimet partiake LV-ja i ka bërë në veçanti në KEK, PTK dhe ujësjellës. "LV-ja i emëroi militantët e vet partiakë, pavarësisht mungesës së kualifikimit të tyre profesional në të gjitha bordet e ndërmarrjeve publike në vend, me theks të

veçantë ato në KEK, PTK dhe ujësjellës. Një pjesë e këtyre emërimeve janë anëtarë të familjeve të ngushta, zyrtarë të pushtetit e militantë partiakë", ka thënë Halimi në një konferencë për medie. Lidhur me raportimet se në konkursin e fundit në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) janë pranuar në punë militantët të LV-së, Halimi ka thënë se kjo është një aferë super "pronto" e kësaj partie. "Rasti i fundit më eklatant është konkursi i KEK-ut, ku aplikuan 4 668 persona, ndërsa janë pranuar 128, prej tyre të gjithë familjarë e

zyrtarë të KEK-ut dhe militantë të partisë së LV-së. Kjo është afëra super 'pronto' e LV-së. Pra bëhet fjalë për 4 500 persona të cilëve iu mohua e drejta e punës vetëm për shkak të përkatësisë së tyre partiakë", ka thënë ajo. Halimi ka kërkuar që trendi i punësimeve familjare dhe partiake të ndalet. Ajo ka thënë se LDK-ja kërkon që ky konkurs të anulohet, teksa ka ftuar prokurorinë t'i fillojë hetimet. "Ftojme prokurorinë që të fillojë hetim të menjëhershëm dhe të marrë masa ndaj keqpërdoruesve", ka thënë zëdhënësja e LDK-së.

## Për tre muaj numër rekord i operacioneve në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Në tre muajt e parë të vitit 2022 Klinika e Kirurgjisë Vaskulare në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka shënuar numër rekord të operacioneve. Në këtë klinikë janë kryer 102 operime të venave varikoze, 14 endarterektomi të arteries karotide (hapja e enëve gjakut

në qafë), 10 aneurizma të aortës abdominale, 25 urëzime arteriale (by pass) në gjymtyrë të poshtme dhe të sipërme dhe janë krijuar ose korrigjuar 70 fistula arteriovenoze për dializë. Po ashtu, janë realizuar 99 ndërhyrje kirurgjike të llojeve të ndryshme. Disa prej këtyre operacioneve shumë

komplekse dhe jo të punuara më parë janë: lëndime të aortës descendente (aorta torakale), raptura spontane të venës cava (qarje të venës kryesore të barkut) dhe aneurizma të aortës me veshka harkore (ren arcuatum). Në të njëjtën kohë, klinika ka hospitalizuar 350 pacientë dhe ka realizuar 1 650 vizita ambulatore.



# Çfarë do të ndodhë me furnizimet e gazit në Evropë?

**PRISHINË, 5 PRILL** - Presidenti rus, Vladimir Putin, po kërkon që për gazin natyror të paguhet me rubla. Gjermania ka nisur të flasë për racionimin e gazit në rast të ndërprerjes së furnizimeve me gaz. Çmimet për karburante, që përdoren për ngrohje të shtëpive, për prodhimin e energjisë elektrike dhe për t'i furnizuar industrinë, janë rritur tej mase. Ka shumë diskutime lidhur me furnizimet me gaz natyror në Evropë, teksa pushtimi rus i Ukrainës po vazhdon.

## Çfarë po propozon Putini?

Putini ka thënë se importuesit e gazit rus tani duhet të paguajnë me rubla. Liderët evropianë kanë thënë se nuk e pranojnë këtë kërkesë, pasi kontratat për furnizim me gaz rus thonë se për këtë produkt duhet të paguhet me euro ose dollar dhe se njëra palë nuk mundet që në mënyrë arbitrare të ndryshojë formën e pagesës.

Ndryshimi i monedhës, përmes së cilës kryhen pagesat, normalisht bëhet pas negociatave të gjata, thanë analistët, dhe klientët kërkojnë diçka në këmbim për ekspozimin që vjen si pasojë e pagesës së rublës, monedhës kombëtare ruse, vlera e së cilës nuk është e qëndrueshme.

Çështjet e hapura lidhur me ndryshimin e monedhës, me të cilën bëhen pagesat, mund të ndikojnë në tregjet energjetike, duke rritur paqartësitë nëse furnizimet me gaz natyror në Evropë mund të ndërpriten dhe të shkaktojnë një goditje të rëndë për ekonominë. Por, Rusia po ashtu varet nga nafta dhe shitjet financojnë Qeverinë ruse, në kohën kur sanksionet kanë goditur sistemin e saj financiar.

Oferta e Kremlinit mund të shihet si një zbrazëturë ligjore. Importuesit, thjesht, mund të hapin një llogari në dollar apo euro në një bankë të caktuar dhe një tjetër llogari bankare në rubla. Importuesit do të paguante për furnizimet me gaz me euro ose dollar dhe direkt banka do të këmbente paratë në rubla. Megjithatë, të premten më 1 prill, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se ndryshimi nuk do të ndodhë menjëherë: "Pagesat mbi furnizimet që janë në progres tani nuk duhet të bëhen sot, por dikur në fund të prillit, ose ndoshta në fillim të majit".

Liderët evropianë e kanë refuzuar kërkesën e Ruses dhe e kanë cilësuar si shantazh. Ata kanë thënë se do të vazhdojnë të paguajnë për gaz me euro dhe dollar. Zyrtarët gjermanë thanë se nuk do të flasin për ndikimin e dekretrit të Putinit, por vetëm janë shprehur se janë duke e analizuar atë. Zëdhënësjja e Ministrisë së Ekonomisë, Beate Baron, theksoi se Gazprombankës së Ruses i është kërkuar dhjetë ditë që ta shpjegojë procedurën, "dhe natyrisht, ne më pas do ta analizojmë atë me kujdes".



Ndërkaq, një zyrtar i lartë i Komisionit Evropian për energjinë tha në "Twitter" se Bashkimi Evropian është duke u koordinuar për të "krijuar një qasje të përbashkët".

## Çfarë po kërkon të arrijë me këtë Putini?

Kremlini ka thënë se ndryshimi i pagesës është i nevojshëm, sepse sanksionet perëndimore kanë ngrirë rezervat e monedhës së huaj. Për shkak se masa shënjestron importuesit e shteteve "jomiqësore", mund të shihet si hakmarrje ndaj sanksioneve të Perëndimit që kanë larguar bankat ruse nga transaksionet financiare ndërkombëtare dhe kanë bërë disa kompani perëndimore që të largojnë bizneset e tyre nga Rusia. Avantazhet ekonomike për Rusinë nuk janë të qarta. Në teori, pagesat me rubla mund ta rrisnin kërkesën për monedhën kombëtare dhe ta ndihmonin Kremlinin të mbështeste kursin e tij të këmbimit, që ka nisur të rritet që prejse ra në nivele të ulëta pas nisjes së pushtimit të Ukrainës. Por, eksportuesit e gazit, Gazprom, veçse ka shitur 80 për qind të fitimeve të tij të huaja për rubla, prandaj një shtytje për monedhën kombëtare ruse do të ishte minimale.

Kremlini ka treguar se dëshiron, gjithashtu, të zgjasë pagesat me rubla për mallra të tjera, siç janë metalet.

Një nga motivet mund të jetë politike, tha Stefan Meister, kreu i programit për rend botëror dhe demokraci në Këshillin gjerman për Marrëdhënie me Jashtë. "Rusia nuk është e interesuar që të bëjë këtë kërkesë vetëm për gaz, por dëshiron një lloj fitoreje politike", tha Meister. "Dëshiron të tregojë se Putini dikton

kushtet nën të cilat eksportohet gaz".

Kjo lëvizje pjesërisht ka në shënjestër audiencën e brendshme në Rusi, tha Meister, pasi Putini po tenton që t'i thotë popullit të tij: "Shikoni, këto janë shtetet armike dhe tani ato duhet të paguajnë nën një skemë tjetër". "Prandaj, mendoj se kjo po ashtu mund të jetë për të marrë mbështetje brenda vendit, duke definuar se kush janë armiqtë", tha Meister.

Një tjetër motiv mund të jetë për të mbrojtur bankën, Gazprombank, që të mos goditet nga sanksionet, sepse kjo bankë do të ishte kanali për pagesat dhe që do të mundësonte që furnizimet me gaz të vazhdonin, tha Meister. Kjo është banka e tretë më e madhe në Rusi, dhe sikur Sberbank - banka më e madhe ruse - nuk është larguar nga sistemi ndërkombëtar i pagesave, SWIFT.

## Çfarë niveli të furnizimeve me gaz ka Evropa?

Sanksionet e koordinuara të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian nuk aplikohen për pagesat për naftë dhe gaz. Ky ishte koncesioni i Shtëpisë së Bardhë për aleatët evropianë, të cilët janë shumë më të varur nga energjia ruse, pasi Moskë siguron 40 për qind të gazit dhe 25 për qind të furnizimeve me naftë të Evropës. Furnizimet me gaz kanë vazhduar përmes tubacioneve që sjellin gazin nga Rusia në Evropë, është thënë në ueb-faqet e operatorëve të këtyre gazsjellësve.

Shumë nuk janë të lumtur që evropianët ende po blejnë energji nga Rusia, e cila mesatarisht përfitoi 43 për qind të fitimeve vjetore qeveritare nga shitja e gazit dhe naftës midis viteve 2011 dhe 2020,

është thënë në të dhënat e Administratës amerikane për Informacione të Energjisë.

Këto para kanë ndihmuar në blerjen e tankeve dhe raketave që po përdoren në pushtimin e Ukrainës. Por, kjo, po ashtu, nënkupton se Rusia ka arsye të forta që të mos ndërpresë furnizimet me gaz natyror.

## A do t'i mbijetonte Evropa një ndërprerjeje të furnizimeve me gaz?

Ekonomia e Evropës do të kishte vështirësi pa gazin rus, edhe pse ndikimi mund të varej nga ajo se sa shtetet e përdorin këtë gaz.

Gjermania - ekonomia më e madhe në kontinentin evropian "është shumë e varur nga furnizimet me energjinë ruse", tha Monika Schnitzer, profesore e Ekonomisë në Universitetin e Mynihut, njëherësh anëtare e këshillit të ekspertëve të ekonomisë të Qeverisë gjermane. "Një pezullim i këtyre furnizimeve sjell rrezikun që ekonomia gjermane të rrëshqasë në një recesion me norma inflacioni dukshëm më të larta", tha ajo.

Inflacioni veçse ka arritur nivel rekord, duke shtrenjtuar të gjitha çmimet, si ato të produkteve ushqimore e deri te lënda e parë. Inflacioni është rritur për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, teksa Evropa përballej me krizë energjetike edhe para se të niste lufta në Ukrainë.

Kriza ka bërë që shumë qeveri dhe kompani të kërkojnë furnizime nga burime të tjera, por edhe nëse sigurohet energji nga burime të tjera, nuk do të ishte e mjaftueshme që të mbulohej nevoja nëse Rusia do t'i ndërpriste furnizimet me gaz. Organizata Bruegel ka

vlerësuar se Evropa do të kishte mungesë prej 10 deri në 15 për qind të kërkesës normale për të kaluar sezonin e dimrit të ardhshëm, duke nënkuptuar se duhet të vendoseshin masa të jashtëzakonshme për të ulur përdorimin e gazit.

Liderët evropianë kanë thënë se nuk mund t'i përballojnë pasojat e një bojkoti të menjëhershëm. Në vend të kësaj, ata planifikojnë ta ulin përdorimin e gazit rus sa më shpejt që të jetë e mundur. Ata po porositin më shumë gaz të lëngshëm natyror, që transportohet përmes anijeve dhe po mëtojnë që të furnizohen me gaz nga gazsjellësit nga Norvegjia dhe Azerbajxhani. Po ashtu, shtetet evropiane kanë përshpejtuar punën për ngritjen e kapaciteteve për prodhimin e energjisë përmes erës dhe diellit dhe po planifikojnë të vendosin masa më të rrepta.

Qëllimi është që të shkurtohet për dy të tretat furnizimi me gaz rus deri në fund të vitit, dhe të shkëputen plotësisht nga gazi rus deri më 2027.

Situata është aq serioze sa që Gjermania ka shpallur një paralajmërim për emergjencë të energjisë. Ky është paralajmërimi i parë i planit emergjent i cili ka tri faza.

Në një emergjencë të plotë rregullatorët qeveritarë do të duhej të vendosnin se cilat kompani do të duhet të ndalonin së përdoruri gaz në mënyrë që shtëpitë dhe spitalet të mund të furnizohen. Prodhuesit e kimikateve, qelqit, metaleve dhe qeramikës, përdorin shumë gaz.

Racionalizimi i gazit do ta godiste ekonominë evropiane, e cila veçse po përballlet me pasojat e luftës dhe çmimet e larta të energjisë kanë rritur inflacionin në nivel rekord prej 7.5-përqindësh. (Associated Press / Përgatiti: Mimoza Sadiku)



# Simon Sebag Montefiore: Stalini dhe Putini, ngjashmëritë dhe dallimet midis 2 diktatorëve

Nga Simon Sebag Montefiore  
"New Statesman"

Kur të ftuarit e vizitorin Vladimir Putin në zyrën e tij në Kremlin, ai u tregonte raftet e librave dhe i kërkonte të zgjidhnin një libër nga biblioteka e Josif Stalinit. Gjysma e librave të Stalinit – zakonisht të shënuara nga vetë udhëheqësi sovjetik me stilolaps të kuq ose jeshil – mbeten në zyrën e Putinit. Siç më tha një nga ministrat e tij, Putin u kërkonte vizitorëve të hapnin librin, dhe ata do të shihnin së bashku shënimet që kishte lënë Stalini. Tek disa kishte ndonjë pashtrikë ironike: "Ha-ha-ha". Ndonjëherë ndonjë shprehje përbuzjeje. Dhe tek të tjerët kishte vetëm një fjalë. Kështu Stalini kishte shkruar fjalën "mësues" në biografinë e Ivanit të Tmerrshëm. Sot njerëzit në mbarë botën po pyesin nëse Putini është Stalini i ri. Karl Marksi tha dikur me shaka se "historia përsëritet dy herë, herën e parë si tragjedi dhe pastaj si një komedi". Në fakt nuk është, por çdo sundimtar rus përballet me disa nga të njëjtat çështje si carët e mëparshëm Romanov dhe sekretarët e përgjithshëm të Partisë Komuniste.

Shumica e liderëve rusë kanë aspiruar të imitojnë arritjet e dy sundimtarëve më të shquar modernë, Pjetrit të Madh dhe Stalinit, të dy carë revolucionarë, dhe që të dy vrasës brutalë. Unë shpresoj që një ditë Rusia të qeveriset nga dikush që nuk e admiron asnjërin prej tyre. Megjithatë Putini nuk është një Stalin. Stalini ishte marksist, ndërsa Putini është një tiran i shekullit XXI, që ndonjëherë ka kopjuar elementë të Romanovëve dhe imperializmit sovjetik, është një populist dhe nacionalist, një praktikues i politikave të identitetit të këtij shekulli, që e përdor ende armët e modës së vjetër, po ashtu edhe armët e reja të teknologjisë së lartë si mediat sociale.

Megjithatë ndikimi i Stalinit është i çimentuar kudo në strukturën shtetërore të Rusisë. Represioni i Putinit në Rusi i ngjan gjithnjë e më shumë tiranisë staliniste, në kultin e saj të frikës, në tubimet e shfaqjeve patriotike, shtypjen e protestave, gënjeshtret e pacipa dhe kontrollin total të medias, edhe pse pa internime dhe pushkatime masive.

Deri më sot. Dhe kjo nuk është diçka e habitshme pasi shteti modern rus që formoi Stalini në fillimin e viteve 1920, nuk u shpërbë kurrë në turbulencat demokratike të viteve 1990. Pavarësisht nga fasada e tij demokratike, ekzekutivi rus mbeti një autokraci në të cilën

presidentët – të ngjashëm me carët e hershëm – zgjidhën pasardhësit e tyre siç kanë bërë Boris Jelcin dhe Putin.

Organizata e sigurisë e themeluar nga Lenini, ÇEKA, e formuar dhe e mikromenaxhuar nga Stalini, e njohur me një sërë shkurtesash të zymta – OGPU, NKVD, MGB, KGB, FSB, u nda nga presidenca në kohën e Jelcinit, por nuk u çmontua asnjëherë.

Si një ish-nënkolonel i KGB-së, Putin është një "çekist" krenar. Pastaj është Ukraina, një vend që u shtyp brutalisht nga Stalini, dhe që sot është sulmuar nga Putin. Presidenti rus ndan një pjesë të vendosmërisë së Stalinit për të likuiduar me çdo kusht kombësinë dhe pavarësinë e Ukrainës.

Dallimet midis të dyve janë po aq të mëdha sa edhe ngjashmëritë. Por ndoshta janë ngjashmëritë, ato që kanë sot rëndësi. Në shumë aspekte Stalini e ka lënë në hije jetën e Putini. Në vitin 1952, kur Stalinit i kishte mbetur një vit jetë, Putini lindi në Leningrad në një Bashkim Sovjetik multi-etnik të skalitur nga Stalini, arritjet e të cilit e dominuan botën e Putinit.


Me një kosto njerëzore të tmerrshme, Stalini e shndërroi pa mëshirë BRSS në një forcë të industrializuar, mundi Hitlerin, sulmoi Berlinin, pushtoi Evropën Lindore dhe e bëri Rusinë një superfuqi bërthamore. Fitorja e vitit 1945 u bë ngjarja që e justifikon autokracinë e Putinit sot.

Putini i ka lavdëruar arritjet e Stalinit, duke theksuar se "që nga viti 1924 deri në vitin 1953, vendi që sundoi Stalini, ndryshoi nga një shoqëri agrare në një shoqëri industriale". Sa i përket Luftës së Dytë Botërore ai është shprehur se "askush tani nuk mund të hedhë gurë mbi ata që organizuan dhe qëndruan në krye të kësaj fitoreje".

Ai e sheh Stalinin si një titan me të meta, i lindur për revolucione si Oliver Kromuelli apo dhe Napoleoni. "Stalini ishte një produkt i kohës së tij" - i tha Putin regjizorit të Hollivudit, Oliver Stoun. "Historia angleze ka Kromuellin... Napoleoni është pothuajse një zot në Francë. Historia është e mbushur plot me personazhe të tillë" - shtoi ai.

Stalini dhe Putin ndajnë besimin se autokracia, e mbështetur nga imponimi, është mënyra më e mirë për të menaxhuar Rusinë. "Rusët kanë nevojë për një Car" - thoshte Stalini. Edhe Putin bie dakord me të. Të dy janë të fiksuar pas historisë. Sa herë që Putin takon historianët, ai i pyet "Si do të më gjykojë historia?".

Historia është vazhdimisht e pranishme për të dy. Kur ish-ambasadori amerikan në Bashkimin Sovjetik, U.Averell Harriman, e uroi Stalinin për



pushtimin e Berlinit, ai u përgjigj: "Po, por Aleksandri I pushtoi Parisin". Por edhe dallimet janë mbresëlënëse. Stalini ishte një gjeorgjian, i lindur me mbiemrin Xhugashvili. Putin, i lindur në Leningrad, e theksoi që në ditët e para të pushtimit të Ukrainës "Unë jam një rus!". Stalini ishte një marksist fanatik internacionalist; ndërsa Putin beson në "botën ruse", duke filluar që me konvertimin ortodoks të Vladimirit të Madh në vitin 1918.

Ai e përbuz ideologjinë marksiste, duke besuar se revolucioni leninist shkatërroi perandorinë ruse. Duke iu shmangur komunizmit, ai promovon kapitalizmin Kremlin-KGB. Stalini, i cili nuk kishte asnjë interes për paratë dhe kishte vetëm disa uniforma (megjithëse i pëlqente përdorimi i pallateve të rehatshme) do të ishte i neveritur nga vulgariteti i jahteve dhe avionëve të ultra të pasurve rusë.

Stalini jetoi për 20 vjet si revolucionar i fshehtë, brenda dhe jashtë burgjeve dhe Siberisë. Putin i ngjiti shkallës e karrierës si një operativ i vogël i KGB-së në kohën e stancionit monumental të burokracisë sovjetike.

Stalini besonte se socializmi mund të përhapej vetëm përmes vrasjeve dhe terrorit. Stalini vrau deri në 20 milionë njerëz të pafajshëm; 18 milionë u futën në në gulagët e tij; dhe shumica prej tyre nuk u kthyen më kurrë në shtëpitë e tyre.

Putin përdor atentate kirurgjikale, edhe pse shpeshherë spektakolare, duke preferuar helmet ekzotike. Edhe pse arritjet e Stalinit, u shoqëruan me një kosto të papranueshme, Putin tha në vitin 2017 në dokumentarin e Stoun se "demonizimi i tepruar i Stalinit, është një mjet për të sulmuar Bashkimin Sovjetik dhe Rusinë".

Edhe pse komunizmi nuk ekziston më, forcat e policisë sekrete të Stalinit janë të paprekura dhe mbeten një element qëndror në mbretërimin e Putinit. Stalini kooptoi qëllimisht kulturën kriminale ruse në ÇEKA, duke e personifikuar vetë lidhjen gangster-bolshevik.

Ai fitoi mbështetjen e Leninit duke organizuar grabitje bankash me një bandë mafiozësh dhe psikopatësh për të financuar Partinë Komuniste. Kur një marksist idealist iu ankua Leninit për dhunën e Stalinit, ai u përgjigj: "Ky është lloji i njerëzve që na duhet".

Putin ka një lidhje të veçantë me shërbimet sekrete. Gjyshi i tij Spiridon Putin ishte një kuzhinier që filloi punë në hotelin Astoria në Shën Petersburg, ku gatuante për Rasputinin. Më pas iu bashkua "stafit të shërbimit" të OGPU/NKVD që punonte në vilat shtetërore, duke i shërbyer Leninit dhe Stalinit.

Si një student i ri në fakultetin juridik, Putin iu bashkua KGB-së në vitin 1975. Gjatë mbretërimit sklerotik të Leonid Brezhnjev (1964-1982), KGB nën drejtimin e të talentuarit Juri Andropov ishte e vetmja organizatë që e ruajti prestigjin e saj. Në vitin 1991 Putin ishte duke punuar si nënkolonel i KGB-së në Drezden të Gjermanisë Lindore kur u shemb Bashkimi Sovjetik.

Ai u rikthye në shtëpi i dëshpëruar. Kur u ngjiti në pushtet si kryeministër në dhjetorin e vitit 1999, ai u besoi mbi të gjitha "çekistëve". Miku i tij i vjetër dhe ish-drejtori i FSB-së, Nikollai Patrushev, që tani është sekretar i Këshillit rus të Sigurimit, ka deklaruar në një rast se oficerët e KGB-së: "nuk janë në punë për

paratë... ata janë fisnikëria e re". Por është një fisnikëri me etikën e një gangsteri. Siç e pranoi edhe Putin kur sulmoi çeçenët: "Ne do t'i vrasim ata edhe në shtëpitë e tyre!". Ata që e tradhtuan këtë "urdhër fisnik", si Aleksandër Litvinenko dhe Sergei Skripal do të likuidoheshin, ashtu si Stalini vrau Trockin dhe shumë të tjerë.

Libri i vizitorëve të Stalinit, zbulon se ai kalonte çdo ditë shumë orë me shefat e tij të policisë sekrete. Të dy diktatorët u dehën nga fitoret. Asnjëri nuk ishte i çmendur, por bindja e të qenit i pagabueshëm është një patologji e trezëshme.

Në moshën 69-vjeçare, Putin është në të njëjtën moshë me Stalinin kur ai bllokoi Berlinin. Edhe në një epokë kur informacioni është i disponueshëm lirisht në internet, Putin është po aq i izoluar sa idhulli i tij. Pas 20 viteve të suksesshme diktaturë, i fshehur në rezidencën e tij në Novo-Ogaryovo, i tmerruar nga Covid-i, i distancuar nga miqtë e tij dikur të besuar, dhe i mashtruar nga një fiksim i deformuar fetishtist nacionalist ndaj Ukrainës, Putini e ka keqkuptuar fatalisht patriotizmin pasionant dhe rezistencën e guximshme të ukrainasve.


Por në Rusi, të rinjtë modernë rusë, të mësuar prej kohësh me udhëtimet ndërkombëtare dhe mediat sociale, janë më pak tolerantë ndaj imperializmit irredentist. Ata po protestojnë me guxim. Mijëra prej tyre janë arrestuar; madje edhe elita e ka denoncuar luftën.

Dhjetëra mijëra rusë po nxitojnë të largohen nga vendi. Vendimi i Putin është "racional" brenda botëkuptimit të tij të shtrembëruar. Por ai është pjesë e një loje të madhe për të siguruar trashëgiminë e tij, për të ndryshuar rrjedhën e historisë dhe për të rivendosur një perandori ruse në këtë botë të re të ndërlidhur nëpërmjet teknologjisë së lartë.

Ndërsa kjo luftë mizore dhe sanksionet perëndimore po e dërmojnë shoqërinë ruse, terrori stalinist do të bëhet thelbësor për qëndrimin e Putinit në pushtet. Nëse humbet, ai mund të rrezohet nga oborrtarët e tij - Carët dhe sekretarët e përgjithshëm janë rrëzuar zakonisht nga grushtet e pallatit dhe jo nga protestat - por ai edhe mund të mbijetojë, siç bëri Sadam Huseini pas dy humbjeve. Nëse do të fitojë, Putin do t'i bashkohet Pjetrit të Madh dhe Stalinit në histori. "Fitimtarët nuk gjykojnë asnjëherë" - thoshte dikur Stalini.

**Marrë me shkurtime**

Shënim: Simon Sebag Montefiore, historian i njohur britanik. Autori i librave bestseller si "Stalini: Në oborrin i Carit të Kuq". Bota.al



QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Sot pritet rizgjedhja e Ademit në krye të FFK-së

Kuvendi i shumëpërfolur për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës do të mbahet sot (e mërkurë) me vetëm një kandidat për kryetar, Agim Ademin. Gramoz Vokrrit iu pamundësua garimi. FFK-ja ka përjashtuar edhe mediet nga ky takim, me arsyen se nuk ka hapësira të mjaftueshme

### "Epoka e re"

PRISHTINË, 5 PRILL - Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Futbollit të Kosovës do të mbahet sot (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në selinë e FFK-së. Lajmi është konfirmuar nga Federata e Futbollit, e cila me këtë rast bëri me dije se mediet nuk do të jenë të pranishme, në përjashtim të "Art Motion" e cila do ta bëjë transmetimin e drejtpërdrejtë të kuvendit. "Federata e Futbollit e Kosovës ju njofton se nesër (më 6 prill 2022), me fillim nga ora 11:00,

do të mbahet Kuvendi i Rregullt Zgjedhor. Kuvendi mbahet në selinë e FFK-së. Për shkak të hapësirës dhe numrit të kufizuar të pjesëmarrësve, ju bëjmë me dije se kësaj radhe është e pamundur të krijojmë hapësirë edhe për mediet për përcjelljen e kuvendit. Megjithatë, Kuvendi do të transmetohet drejtpërdrejt në 'Art Motion' si dhe në rrjetet sociale të FFK-së, prandaj të gjithë ecurinë e Kuvendit do të mund ta ndiqni drejtpërdrejt. Pas përfundimit të Kuvendit, presidenti Ademi, njëherësh kandidati i vetëm në zgjedhjet e 6 prillit, do të jetë në

dispozicion për të dhënë prononcime dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja", thuhet në njoftimin e FFK-së. Agim Ademi është kandidati i vetëm në garë për kryetar të FFK-së pasi Gramoz Vokrrit u eliminua nga kjo garë për shkak të disa nënshkrimeve të delegatëve të cilat ishin shpallur të pavlefshme. Siç dihet, Gjykata Themelore e Prishtinës të hënën ia ka refuzuar ankesën Gramoz Vokrrit. Ky i fundit ishte ankuar në gjykatë, se Kuvendi Zgjedhor i FFK-së është i parregullt. Por, kjo gjykatë e ka vlerësuar të pabazë ankesën e tij.



## Sonte përballjet e dyta çerekfinale në Ligën Unike



PRISHTINË, 5 PRILL - Ndeshja e dytë çerekfinale e Ligës Unike zhvillohen sot (e mërkurë). Në gjysmëfinale kualifikohen skuadrat që janë më të mira nga dy ndeshjet. Në takimin e parë Teuta mundi Tirana Neptunin 96:81 dhe me 15 pikë epërsi hyn para sfidës së dytë çerekfinale. Tiranasi, në anën tjetër, do të tentojnë ta bëjnë mrekullinë dhe ta

rikthejnë rezultatit, edhe pse do ta kenë shumë të vështirë të depërtojnë në gjysmëfinale. Takimi tjetër është ndërmjet Prizrenit 16 dhe Rahovecit. Prizrenasi fituan në palestrën "Mizahir Isma" me rezultat 93:98 dhe hynë me pesë pikë epërsi para duelit të dytë. "Vreshtarët" do të tentojnë të fitojnë me më shumë pesë pikë dallim, ndërkohë

prizrenasi synojnë ta ruajnë epërsinë e krijuar dhe të kualifikohen në gjysmëfinale. Golden Eagle Ylli dhe Peja janë kualifikuar në gjysmëfinale, nga vendi i parë, përkatësisht i dytë.

### Çerekfinalët e dyta

**Të mërkurën takohen:**  
19:00 Tirana - Teuta  
20:30 Prizreni 16 - Rahoveci

## Krenohet FFK-ja: 12 fusha për 12 klube



PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Federata e Futbollit të Kosovës është krenuar se në katër vjetët e fundit janë rregulluar 12 fusha. FFK-ja njofton se gjatë katër vjetëve të fundit rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe infrastrukturës. Krijimi i

kushteve për klubet për ta zhvilluar aktivitetin e tyre për të gjitha gjeneratat ka qenë i shtrirë në të tërë vendin. "FFK ka realizuar projektin '12 fusha për 12 klube', duke u siguruar atyre fusha me bari sintetik të një kualiteti të lartë, me

dimensione standarde (105/68 m). Qytetet të cilat kanë përfituar nga ky projekt janë: Prishtina dy fusha, Gjilani dy fusha, ndërsa nga një fushë është investuar në Sadovinë/Viti, Ferizaj, Prizren, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë, Lipjan dhe

Podujevë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Federata e Futbollit e Kosovës ka paralajmëruar se ky është një nga projektet të cilët do të vazhdojnë edhe në vitet e ardhshme me qëllim të zhvillimit sa më të mirë të futbollit në vend.

## Penza dhe Bashkimi në kërkim të finales

PRISHTINË, 5 PRILL - Sot (e mërkurë) zhvillohet ndeshja e tretë gjysmëfinale e "play-off" - it në Superligën e Femrave në mes të Penzës dhe Bashkimit. Në këtë takim do të përcaktohet se kush do të kualifikohet në finale. Sfida zhvillohet me fillim nga ora 20:30 dhe do të transmetohet në Art Motion dhe Kujtesa. Në dy takimet e mëparshme në "play-off" të

dyja skuadrat shënuan nga një fitore ndaj njëra-tjetrës si mysafire. Në Pejë triumfuan vashat e Bashkimit me rezultat 61:76, ndërsa në Therandë fituan vashat pejane me shifrat 68:82. Skuadra pejane kishte përfunduar garat e rregullta në pozitën e dytë me 15 fitore e pesë humbje, kurse ajo prizrenase e treta me 12 fitore e tetë humbje. Prizrenaset, pas

Kupës, duan edhe titullin kampion, kurse pejanet për ta mbrojtur titullin e fituar në edicionin e kaluar. Skuadra që kualifikohet në finale do të përballlet me Prishtinën që eliminoi Trepçën dhe në "play-off" do ta ketë përparësinë e fushës vendase, pasi në garat e rregullta kishte 20 fitore në 20 ndeshje. Skuadra që shënon tri fitore shpallet kampione.



## Gjykata e Tiranës i heq masën e pezullimit nga detyra Armand Dukës

TIRANË, 5 PRILL - Armand Duka tashmë mund ta ushtrojë me kompetencë të plotë detyrën si president i FShF-së. Edhe pse para pak kohësh Duka u rizgjidh

president i FShF-së, deri më sot nuk e kishte të drejtën ta ushtronte detyrën e tij pasi ai mbante mbi shpatulla masën e pezullimit. Gjykata e Tiranës ka

hequr masën e pezullimit nga detyra për kreun e FShF-së, Armand Duka dhe sekretarit të përgjithshëm të FShF-së, Ilir Shulku. Ata do të hetohen në

gjendje të lirë nga Prokuroria e Tiranës për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës". I pezulluar mbetet vetëm Ardian Haçi.



## Sonte përballen Chelsea - Real dhe Villarreal - Bayern

PRISHTINË, 5 PRILL (ER) - Chelsea dhe Real Madridi do ta zhvillojnë përballjen e parë të çerekfinaleve në Ligën e Kampionëve në "Stamford Bridge". Skuadra e Thomas Tuchel u kualifikua në këtë fazë, pasi mposhti kampionët e Ligës 1 me rezultat të përgjithshëm 4-1, ndërsa skuadra e drejtuar nga Carlo Ancelotti bëri një rikthim sensacional kundër Paris Saint-Germain dhe u kualifikua me rezultat të përgjithshëm 3-2. Chelsea ka pasur një ecuri fantastike, por në fundjavë u mposhtë nga Brentfordi (4-1), derisa Real Madridi e mposhti Celta Vigon me rezultat 1-2 në kuadër të La Ligës. Në këtë ndeshje Chelsea do të jetë pa mbrojtësin Ben Chilwell dhe mesfushorin Callum Hudson-Odoi, në anën tjetër Real do të ketë mungesën e Eden Hazardit, kurse në dyshim është Luka Jović. Sonte zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes të Villarrealit dhe Bayern Munchenit. Villarreali është gatë të vazhdojë befasinë në Ligën e Kampionëve. Pasi e eliminoi skuadrën e Juventusit, do të



### FORMACIONET E MUNDSHME:

**Chelsea:** Mendy; Azpilicueta, Silva, Rudiger; James, Jorginho, Kovacic, Alonso; Ziyech, Havertz, Pulisic.

**Real Madrid:** Courtois; Carvajal, Militao, Alaba, Mendy; Kroos, Casemiro, Modriq; Asensio, Benzema, Vinicius Junior.

**Villarreal:** Rulli; Aurier, Albiol, Torres, Estupinan; Pino, Parejo, Capoue, Trigueros; Danjuma, Moreno.

**Bayern Munchen:** Neuer; Pavard, Sule, Upamecano, Hernandez; Kimmich, Goretzka; Sane, Muller, Coman; Lewandowski.

mundohet të bëjë të njëjtën gjë edhe me Bayern Munchenin, ani pse skuadra gjermane është favorite në

letër. Bayerni e eliminoi Red Bull Salzburgun për ta siguruar kualifikimin në çerekfinale.

## Paralajmërohet spektakël i jashtëzakonshëm në Prishtinë FIBA 3x3

PRISHTINË, 5 PRILL - Në Prishtinë do të mbahet një ngjarje e jashtëzakonshme në 3x3. Për herë të parë do të mbahet 3x3 Challenger, që do të organizohet nga 3x3 Prishtina, në mbështetje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), komuna e Prishtinës dhe Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK).

Drejtori i Eventit, Fisnik Juniku, ka dhënë informacione për këtë ngjarje. "Ky event i madh do të mbahet më 16-17 korrik në sheshin 'Zahir Pajaziti' në Prishtinë nga ora 16:00 deri në orën 24:00. Për dy ditë me radhë do të jetë një spektakël i madh i 3x3. Në këtë Challenger do të marrin pjesë 12 ekipe të huaja dhe katër ekipe nga Kosova përmes Wild Card të ndryshëm", është shprehur Juniku për faqen



zyrtare të FBK-së, duke shtuar: "Vendi i parë, i dytë dhe i tretë së bashku do të fitojnë deri në 40 mijë euro. Po ashtu, finalistët kualifikohen për në Debreçen të Hungarisë, në Masters, në eventin më të madh që mbahet. Kjo është hera e parë që në rajon mbahet një Challenger. Nuk mbahet as në Mal të Zi, në Maqedoninë Veriore apo në Shqipëri. Është arritur për 3x3 Prishtinë, që për vitin e pestë të themelimit po arrin të mbajë

një garë të tillë në kryeqytetin e Kosovës. Dua të falënderoj Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Federatën e Basketbollit të Kosovës, komunën e Prishtinës, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe të gjithëve për përkrahje. Në maj do të mbajmë një konferencë për hollësitë e ardhshme".

Ndërsa sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ishte e lumtur që do të përkrahin një ngjarje të tillë. "Federata e Basketbollit e Kosovës është e gatshme të mbështetë një ngjarje të tillë. FBK e ka edhe në planin strategjik zhvillimin e basketbollit 3x3. Ne jemi shumë të lumtur që Kosova është nikoqire e një ngjarjeje të tillë, në të cilën të marrin pjesë ekipe nga Evropa. Besoj se do të jetë një spektakël për adhuruesit e 3x3", ka thënë Dushku për faqen zyrtare të FBK-së.

### SHKURT

#### Simonovski, 'ylli i javës' në Superligë

Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës". Këtë çmim për xhiron e 27 e ka fituar futbollisti i KF Dritës, Marko Simonovski. Sulmuesi maqedonas pati paraqitje të shkëlqyeshme në fitoren e rëndësishme të skuadrës së tij kundër Ulqianës si mysafire me rezultat 3:2. Marko Simonovski realizoi dy gola në minutat 25-të dhe 59. Pas fitores në Lipjan, Drita FC renditet në pozitën e dytë, me 49 pikë.

#### Ylli i NBA-s: Sezoni ynë u shkatërrua për shkak të lëndimit tim

Sezoni 2021-2022 ka qenë me luhataje për skuadrën e Brooklyn Netsit, që aktualisht renditet në vendin e 10 në Konferencën e Lindjes në NBA. Ai ka siguruar pjesëmarrjen në fazën "play-in", ku do të luajë një ndeshje shtesë për të hyrë në "play-off". Gjithsesi, nga ekipi i Netsit pritej më shumë këtë sezon, por mjaft ngjarje kanë kushtëzuar rezultatet e deritanishme. Kevin Durant, ylli i NBA-s dhe këtij ekipi, ka folur për paraqitjen e tij, duke thënë se lëndimi që ai pësoi pak kohë më parë ndikoi në rendimentin e skuadrës. "Sezoni ynë u shkatërrua për shkak të lëndimit tim. Unë e shoh në këtë mënyrë. Lëndimi im dhe fakti që Irving ishte shpesh jashtë për shkak të protokollit ndikuan në rezultate", ka thënë Durant.

Në kohën që Duranti mungoi, skuadra e Brooklynit fitoi vetëm 5 nga 22 ndeshje. "Kur në fushë luajmë të gjithë bashkë më pëlqen ajo që bëjmë. Në 'play-in' nuk trembem nga rivalët, le të luajmë ndaj kujtdo. Më intereson vetëm të jemi të gjithë dhe të japim më të mirën, pasi fitorja do të vijë", u shpreh Kevin Duranti, dy tituj kampionë në NBA.

#### Pioli 'vajton' barazimin ndaj Bolognas

Trajneri i AC Milanit, Stefano Pioli, e ka pranuar se barazimi ndaj Bolognas (0-0) është një mundësi e humbur për kuqezinjët, por ka hedhur poshtë sugjerimet se skuadra e tij po vuan nga presioni i të qenit lider. "Është lehtë të analizohet ndeshja e së hënës. Nuk ishim në gjendje të gjenim momentin e duhur, topin e fundit, kthesën, goditjen që mund ta ndryshonte. Bëmë gjithçka tjetër. E përjashtoj krejtësisht idenë se ishte çështje psikologjike. Skuadra luajti me karakterin e duhur, temperamentin dhe mentalitetin, madje edhe me cilësi deri në fazën finale. Ekipi im ka dëshmuar se është gjallë dhe po godet, ka cilësi dhe meriton të jetë aty duke sfiduar deri në fund", ka thënë Pioli për "Sky Sport Italia".

#### Gazetari Riolo: Mbappe do të nënshkruajë për PSG-në

E ardhmja e Kylian Mbappes mbetet e gjitha për t'u përcaktuar, mbetet një temë e hapur që vijon të prodhojë lajme pa fund. E fundit dhe jo pak e bujshme vjen nga Franca. "E di që askush nuk do ta besojë, por Mbappe do të firmosë me PSG-në rinovimin e kontratës. Zyrtarizimi do të vijë në maj", u shpreh Daniel Riolo, gazetari i "RMC Sport", i cili ishte i pari që publikoi transferimin e Leo Messit në Paris. Pavarësisht këtij detaji të bërë publik së fundmi, Karim Benzema, sulmuesi i Real Madridit, e fton publikisht Mbappen t'i bashkohet në Madrid.

## Barça heq dorë nga transferimi i Salahut

Barcelona ka vendosur të përjashtojë si alternativë sulmuesin egjiptian Mohamed Salah për shkak të kërkesave të larta ekonomike. Mësohet se

Salah pretendonte një pagë prej 17 milionë eurosh në sezon për pesë vjetet që do të nënshkruante me Barçën. Salah, kontrata e të cilit përfundon në qershor

2023, nuk ishte fleksibël në këtë pikë, ndaj Barcelona, duke pasur parasysh qëndrimin e palëkundur të sulmuesit, u detyrua ta përjashtonte operacionin,

pavarësisht se ishte një lojtar që i pëlqente shumë sekretariatit teknik deri në atë pikë sa të ishte alternativa më reale në rast se norvegjezi Erling

Haaland nuk do të vinte në "Camp Nou". Gjithashtu, as Liverpooli nuk do të pranonte një ofertë më të vogël se 70 milionë euro për Salahun.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), nenit 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 39 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 536 të datës 04.04.2022 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

### KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

<b>1. Pozita:</b>	<b>Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë serbe anasjelltas;</b>
<b>Numri i referencës:</b>	PSA/ZKA/09-04/22
<b>Grada:</b>	ZKA-C6
<b>Numri i pozitave:</b>	Një (1)
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndhmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bënë përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndhmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe në përputhje me normat gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të gjitha dokumenteve;

#### Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale prej tyre një (1) vit dëshmi në fushën e përkthimit.

#### Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysht. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 06.04.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 21.04.2022, ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu (izmenjen/dopunjen), članom 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu dana 16.09.2021); vezano sa članom 39 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; kao i Odluke Generalnog Revizora Br. 536 datuma 04.04.2022 za popunjavanje slobodnog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

### KONKURS

za popunjavanje slobodnog radnog mesta

<b>1. Položaj:</b>	<b>Prevodilac - sa albanskog na srpski i obrnuto;</b>
<b>Broj reference:</b>	PSA/ZKA/09-04/22
<b>Nivo:</b>	ZKA-C6
<b>Broj radnih mesta:</b>	Jedno (1)
<b>Trajanje imenovanja:</b>	Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže vodi odeljenja u postavljanju ciljeva i izradi planova rada;
- Vršiti prevod dokumenata sa albanskog na engleski i obrnuto prema normi utvrđenoj za radni dan. Prosečna norma za prevodenje dokumenata u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči.
- Vršiti simultano prevodenje na radnim sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i u drugim slučajevima prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u definisanju i usaglašavanju terminologije, za prevedene dokumente i dokumente, kao i njihovu tačnost sa jasnim značenjem i u skladu sa normama gramatike i sintakse;
- Održava bazu podataka i informacije u vezi sa prevodom svih dokumenata;

#### Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva od kojih jedna (1) godina dokaz u oblasti prevodenja.

#### Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

#### Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

#### Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počevši od 06.04.2022.godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije 21.04.2022.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

# NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

## Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

# SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Fringemarket Corporation" Kosovo Branch me seli ne Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik 810850281.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

